

Përmbushja e 12 zotimeve



RAPORTI 2016

**Prishtina
po bëhet**



12 ZOTIMET

Për mandatin 2014-2017

ne u zotuam që do të realizojmë:



Furnizim i pandërprerë me ujë për 24 muaj

- Vlerësimi i humbjeve
- Plani investimeve kapitale
- Realizimi i investimeve



Arsimi në shërbim të zhvillimit

- Përzgjedhja e drejtorëve me pjesëmarrje në komunitet
- Vlerësimi i punëtorëve të arsimit në bazë të performancës
- Shujta falas për klasat e ulëta
- Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve



Tregu i prodhimeve të vendit

- Treg për bujqit vendorë që në Prishtinë t'i shesin prodhimet e tyre pa taksa shtesë
- Lidhja në mes të institucioneve, dhe grupeve të tjera në Prishtinë me prodhues vendor



Çerdhe me kosto të përballueshme në çdo pjesë të komunës

- Vlerësimi i nevojave
- Diskutimet publike
- Plan aksionar për çerdhet



Barazi në Prishtinë

- Programi për qasje në institucionet publike për personat me aftësi të kufizuara
- Programi i integritetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Heqja e taksave administrative për rastet sociale dhe programe të lirimit nga pagesa e shërbimeve komunale për grupet e rrezikuara



Banim i përballueshëm

- Banim i përballueshëm për punëtorë të sektorit publik
- Mundësi për shërbyesit publikë që shërbejnë më shumë se 10 vjet në sektorin publik



Shëndeti në shërbim të zhvillimit

- Zonimi i qytetit: çdo banorë ka mjekun e vetë
- Sistemi i informimit në shëndetësi, çdo banorë ka kartelën e vetëdigjitate
- Shërbime të rregullta mjekësore e stomatologjike në shkollë për qëllime preventive
- Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre



Reformimi i tatimit në pronë

- Shkallët e reja të tatimit në pronë, sipas gjendjes materiale dhe numrit të banorëve në objektet banesore



Rregullimi i trafikut në Prishtinë

- Reformimi i transportit publik
- Sistem i ri i linjave me orar të parashikueshëm dhe që mbulon të gjitha lagjet
- Sistem i ri i pagesave
- Transporti falas për pensionistë, raste sociale dhe grupe të tjera
- Politika të kufizimit të qarkullimit të makinave në qendër



Vendosja e rregullit në planifikim urban

- Planet rregulluese
- Përfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve
- Ndalja e ndërtimeve pa leje



Hapja e Komunes për qytetarë

- Kërkesat administrative kanë përgjigje para afatit ligjor
- Qytetarët informohen nga Komuna për kërkesat e tyre
- Publikimi i raporteve financiare çdo tre muaj
- Prokurimi sipas modelit të transparencës radikale
- Punësim sipas modelit të anonimitetit, që është provuar në shtetet e Bashkimit Evropian



Vendimmarrja në lagje

- Funksionalizimi i bashkësive lokale për t'i përmbush nevojat e qytetarëve
- Riorganizimi i këshillave të lagjeve dhe ndërtësive

2014

2015

2016

2017

Tre vjet pas realizuam 90% të zotimeve që kemi prezantuar gjatë fushatës zgjedhore.



Çerdhe me kosto të përballueshme në çdo pjesë të komunës

- ✓ **Vlerësimi i nevojave** - Është bërë vlerësimi i nevojave për çerdhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës së Prishtinës dhe kemi përgatitur planin aksionar për hapjen e çerdheve të reja, me çmim të përballueshëm, në çdo pjesë të Prishtinës.
- ✓ Hapja e çerdhes *"Botanika"*, në lagjen "MATI II", 80 fëmijë, më 17 gusht 2015;
- ✓ Hapja e çerdhes *"Ngjyrat"*, në lagjen "Hajvalia", 40 fëmijë, më 26 tetor 2015;
- ✓ Hapja e çerdhes *"Shtëpia Magjike"*, në fshatin Besi, 40 fëmijë, më 18 dhjetor 2015;
- ✓ Hapja e çerdhes *"Shkronjat"*, në lagjen "Arbëria III", 101 fëmijë, më 19 maj 2016;
- ✓ Është në proces të hapjes çerdhja *"Zogjtë"* në lagjen "Sofalia", 70 fëmijë, në janar 2017
- ✓ Është në përfundim ndërtimi i çerdhes në lagjen "Kodra e Trimave", 240 fëmijë, hapja në mars 2017;
- ✓ Ka filluar renovimi i objektit për hapjen e çerdhes në lagjen "Tophane", 60 fëmijë.



Arsimi në shërbim të zhvillimit

- ✓ **Kifle dhe qumësht falas** për të gjithë fëmijët në klasat 1-5 dhe për nxënësit e klasave të 6-9-ta në shkollat e përfshira në mësimin tërëditor.
- ✓ **Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve** – tashmë në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës janë vendosur dollapët për secilin fëmijë (klasat 1-5).
- ✓ **Përzgjedhja e drejtorëve me pjesëmarrje në komunitet**
Drejtorja e Arsimit ka përgatitur dhe aplikon formularët standard për përzgjedhjen e stafit drejtues në institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar. Përzgjedhja e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të institucioneve edukativo-arsimore



bëhet me përfshirjen e përfaqësuesve të këshillit drejtues, të këshillit të prindërve, të komunitetit, të shoqërisë civile dhe ekspertë të jashtëm.

- ✓ **Ngritja e cilësisë përmes procesit të regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (X)** - duke respektuar në përpikëri kriteret e përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kriteret e Drejtorisë së Arsimit dhe Udhëzimi administrativ nr. 22/2013, numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-

nxënës, kemi ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mësimin.

- ✓ **Trajnim për zhvillim profesional të personelit edukativ**, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe OJQ të ndryshme;

- ✓ **Funksionalizimi i këshillave drejtues në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës**

- ✓ **Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme shkollore**

Pajisja e shkollave me kabine të mësimore të kimisë, biologjisë dhe fizikës;

Pajisja e 29 institucioneve edukativo-arsimore me pajisje teknologjike (90 kompjuterë, 65 lloptopë, dhe 30 projektorë);

Pajisja e 7 shkollave me biblioteka shkollore;

Përmirësimi i infrastrukturës në sallat e edukatës fizike të 5 shkollave;

Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive në këto shkolla:

SHFMU *"Dardania"* – është rregulluar terteni sportiv,

SHFMU *"Naim Frashëri"* – është rregulluar oborri,

SHFMU *"Faik Konica"* – në proces,

SHFMU *"Gjergj Fishta"* – është rregulluar terreni sportiv;



SHMFU *"Nexhmi Mustafa"* – është rregulluar terreni sportiv,

SHFMU *"Ismail Qemali"* – Prishtinë (në proces, bashkëfinancim me Demos);

- ✓ Ka filluar zbatimi i **projektit për digjitalizimin e ditarëve** në 5 shkolla fillore dhe të mesme të larta;
- ✓ Ka filluar zbatimi i **projektit të mësimin tërëditor** në 3 shkolla: *"Model"*, *"Faik Konica"* dhe *"Afrim Gashi"*;
- ✓ **Promovimi i leximit tek fëmijët e shkollave fillore** – Në kuadër projektin "PRISHTINA LEXON", përmes të cilit synojmë të nxisim dëshirën dhe të krijojmë shprehje të leximit te fëmijët, për dy vite radhazi kemi organizuar kampanjën e leximit "Prishtina Lexon" dhe garën për *"Përrallën më të bukur për Prishtinën"*. Duke e ditur se qëllimi i këtij projekti nuk mund të realizohet vetëm përmes kampanjave dhe garave, kemi filluar investimet edhe nëpër shkolla, duke shndërruar këndet e pashfrytëzueshme nëpër shkolla në hapësira atraktive në **KËNDE TË LEXIMIT**. Këndet e leximit deri më tani janë realizuar në **26 shkolla**.






Tregu i prodhimeve të vendit



- ✓ **Hapja e tregut për bujqit vendorë** – nga muaji nëntor, 1200 fermerë të komunës së Prishtinës dhe komunave përreth, kanë filluar të shesin produktet e tyre tri herë në javë, në nëntë lokacione të ndryshme në lagje të Prishtinës. Për herë të parë prodhuesit vendorë kanë hapësirë të sigurt, pa pagesë dhe të përshtatshme për të shitur produktet e tyre. Po ashtu, për herë të parë qytetarët kanë mundësi të blejnë produkte të sigurta vendore. Në këtë projekt, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së, janë investuar mbi **479,397.00 euro**;
- ✓ Lidhja në mes të institucioneve dhe grupeve të tjera në Prishtinë me prodhuesit vendorë;
- ✓ **Përkrahja e fermerëve vendorë** për të ndihmuar në rritjen e prodhimeve të produkteve vendore dhe zhvillimin ekonomik të Prishtinës;
- ✓ **Panairi "Blej Shqip"** - nismë që filloi në vitin 2014, e cila bën reklamimin e prodhimit vendor nga të gjitha trevat shqiptare për të nxitur rritjen e konsumit të prodhimeve shqiptare, si motori kryesor i zhvillimit ekonomik. Ky organizim krijon mundësi për sipërmarrësit nga Kosova, Shqipëria dhe trevat tjera, të mësojnë për prodhimet e njëri-tjetrit dhe të gjejnë format e bashkëpunimit në mes tyre, në mënyrë që të zhduken të gjitha barrierat e mundshme mes tyre.

Meliorimi i livadheve dhe kullosave	140 fermerë	17,150.00 euro
Përkrahja e fermerëve për mbjelljen e patateve	67 fermerë	79,930.00 euro
Përkrahja e fermerëve në perimtari-serra	27 fermerë	201,000.00 euro
Përkrahja e fermave në lëmin e shpeztarisë -pulave vojse	18 ferma komerciale	219,520.95 euro
Veterina mobile-vaksinimi i gjedheve dhe qenve shtëpiakë, si edhe mbarësim artificial i gjedheve		3,756.00 euro
Përkrahja e bletarëve në bletari	282 bletarë	98,770.00 euro
Përkrahja e fermerëve për mbjelljet vjeshtore-grurë	819 fermerë	259,560.00 euro
Përkrahja e fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore	55 fermerë	40,672.00 euro
Përkrahja e fermerëve për ngritjen e pemishteve me mjedër	35 fermerë	91,000.000 euro
Përkrahja e fermerëve në blegtori	727 fermerë	257,464.00 euro



Vendosja e rregullit në planifikim urban

- ✓ **Ndalja e ndërtimeve pa leje;**
- ✓ **Procesi i legalizimit** – Ka përfunduar regjistrimi i ndërtimeve pa leje dhe ka filluar faza e aplikimit për trajtim të tyre. Procesi është në vazhdim e sipër dhe do të përfundojë në afatin e paraparë;
- ✓ **Publikimi i lejeve të ndërtimit në web-faqen e Komunës** - Për vitin 2013, kemi 112 leje të publikuara, për vitin **2014**, kemi **83** leje të publikuara, për vitin **2015**, kemi **158** leje të publikuara, kurse në vitin **2016** (deri sot) kemi **138** leje të publikuara;
- ✓ **392 leje ndërtimi** – Në vitin **2014** janë dhënë **84 leje ndërtimi**, në vitin **2015** janë dhënë gjithsej **159 leje ndërtimi**, kurse në vitin **2016** (deri më 30.11.2016) janë dhënë **149 leje ndërtimi**;
- ✓ Është lansuar shërbimi 'online' për informata nga planet e niveleve të ndryshme komunale, ku gjatë vitit 2016 (deri sot) janë dhënë rreth 1300 informime 'online';
- ✓ Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi brenda afatit ligjor;
- ✓ Zgjidhjet urbane që sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, u paraprijnë kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë I dhe II - themelimi i kolegjiut për shqyrtim të lëndëve; Është bërë revidimi i Planit rregullues "Arbëria III", i cili është miratuar dhe ka hyrë në fuqi;
- ✓ Është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" dhe është në përgatitje për t'u dërguar në Kuvend për miratim;
- ✓ Është miratuar vendimi për lënie në shqyrtim publik të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 2" dhe është në përgatitje për t'u dërguar në Kuvend për miratim;
- ✓ Është miratuar nga KK i Prishtinës Plani rregullues i hollësishëm "Sofalia 2016-2024";
- ✓ Është miratuar vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B17, B18,

B19 dhe B20, lagjja "Mati 1" dhe është përfunduar drafti i planit për vënie në dispozicion për publikun, pritet të merret vendim për këtë;

- ✓ Është miratuar vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për një pjesë të lagjes "Dodona";
- ✓ Është miratuar vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re", Zona Lindje;
- ✓ Është dërguar në Kuvend propozimi për rikategorizim të parku "Gërmia" në "Peizazh të mbrojtur" dhe pritet miratimi i tij;
- ✓ Është hartuar dokumentacioni lidhur me caktimin e lokacioneve për qoshqe dhe pritet miratimi i tyre nga Kuvendi komunal;
- ✓ Avancimi dhe plotësimi i "Permit Tracking System" me lëndët në trajtim;
- ✓ Është marrë vendimi nga Kuvendi komunal për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant;
- ✓ Ftesa publike për të interesuarit për shprehje të interesit për t'u listuar në listën e inxhinierëve, për të bërë pranimin teknik për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi me Ligjin e vjetër të ndërtimit, si dhe mbikëqyrjet inspektuese sipas Ligjit të ri të ndërtimit;
- ✓ Bashkëpunimi me Komunën dhe Demos-it për krijimin e profilit të hapësirave publike;
- ✓ Është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi "One Stop Shop" në mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Komunës së Prishtinës, kompanisë së ujësjellësit rajonal – KUR "Prishtina" dhe Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike- KEDS, SH.A.;
- ✓ Kanë filluar përgatitjet për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës, sipas UA nr. 24/2015, është krijuar baza e të dhënave në sistemet AutoCad dhe GIS, me të gjitha planet e unifikuara rregulluese, Planin zhvillimor urban dhe Planin zhvillimor komunal, pronat komunale, infrastrukturën sociale, infrastrukturën teknike nëntokësore dhe mbitokësore, rrugët ekzistuese, të projektuara dhe të planifikuara, identifikimin e problematikave në rastet specifike të planeve të niveleve të ndryshme komunale, asetet në Komunën e Prishtinës, sipas listës së Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (Nr. 116/2015, datë: 09.10.2015).





Hapja e komunës për qytetarë

- ✓ **E-Rekrutimi** - Mundëson aplikimin 'online' për çdo pozitë të lirë në Komunë, informata rreth aplikantëve, informata për rezultatet e rekrutimit, mundësinë e dërgimit të ankesës 'online' dhe shumë opsione tjera. Po ashtu, mund të njoftoheni për drejtorinë, strukturën e të punësuarve, manualin e përgatitur për qytetarët dhe të tjera.
- ✓ **E-shpenzimet** – Aplikacioni për telefoni mobile (IOS dhe ANDROID versionet) i cili shkarkohet dhe instalohet në telefonat e mençur mobilë. Në këtë aplikacion paraqiten shpenzimet e Komunës, të ndara në 5 kategori buxhetore si dhe lajmet më të reja nga Komuna. Pasqyrimet në bazë të kategorive dhe drejtorive, janë paraqitur në formë grafike dhe të prezantuara edhe me vlera të



shpenzimeve.

- ✓ **Infografikat** – Projekt i cili përfshin broshura dhe tabela informuese për Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Kadastrit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Urbanizmit. Informatat përfshijnë të dhëna se ku duhet të drejtohen qytetarët për problemet apo nevojat e tyre, cilat dokumente u nevojiten për t'u pajisur me çdo lloj të vërtetimit ose dokumentit që lëshon Komuna. Të

tri këto produkte janë të ndërlidhura me zbatimin e Planit të integritetit, të cilin Komuna e Prishtinës, së bashku me UNDP-në, e kanë përpiluar në fillim të mandatit qeverisës. Produktet e prezantuara janë të bazuara në objektivat kryesore të planit të integritetit – në efikasitet, efektivitet, transparencë dhe luftimin e korrupsionit.

- ✓ **E-Kiosku** – Komuna e Prishtinës bëhet ndër komunat e para në rajon me instalimin e E-Kioskut. Përmes E-Kioskut, qytetarët mund të pajisen me 5 certifikata të ndryshme, me çmim të njëjtë, në kohë shumë të shkurtë (2-3 min), shtatë ditë në javë për 24 orë.
- ✓ **Certifikata "online"** – Shërbim i shpejtë përmes internetit - për 48 orë certifikata arrin në shtëpi.
- ✓ **Sistemi i pritjes** – Ka përmirësuar shërbimet e Komunës, si dhe ka lehtësuar procesin e marrjes së dokumenteve personale dhe ka ulur kohën e pritjes nga 2-4 orë në më pak se 5 minuta. Tani të gjitha procedurat për nxjerrjen e dokumenteve kryhen në një sportel. Sistemi i pritjes është zgjeruar në të gjitha drejtorinë të cilat kanë punë me palë.
- ✓ **Prokurimi Transparent** – Është ofruar qasje e plotë në prokurim për shoqërinë civile dhe qytetarët.
- ✓ **Zgjatja orarit për ofrimin e shërbimeve komunale** - Është zgjatur orari i punës për Zyrën e Gjendjes Civile për shërbimet ndaj qytetarëve, prej 8:30 – 17:30 (e hënë – e premte) si dhe ditën e Shtunë orari është 9:00 – 12:00; Zyrrat pritëse punojnë edhe gjatë pushimit të drekës nga ora 12:00 - 13:00;

- ✓ **Pajisja e punonjësve me uniforme** – Të gjithë punonjësit janë pajisur me uniforma dhe bartin ID kartelën, në mënyrë që të mund të identifikohen lehtë, nëse qytetari ka vërejtje për dokumentet. Tani qytetarët shënojnë vetëm numrin personal dhe përzgjidhet dokumenti që u nevojitet.
- ✓ **Përgjigjet në ankesat e qytetarëve bëhen brenda afatit të paraparë me ligj;**
- ✓ **Vulat në çdo bashkësi lokale** – Qytetarët nuk kanë nevojë të vijnë për një vulë në Komunë;
- ✓ **Ofrimi i informacioneve të sakta për përfituesit e Skemës së Asistencës Sociale dhe largimi i taksës së pagesës prej 3 eurove për familjen aplikuese për SAS.** Kjo është arritur në bashkëpunimin e ngushtë mes DKSHMS dhe Drejtorisë së Urbanizimit, me ç' rast asnjë nga palët e Skemës së Asistencës Sociale nuk kanë nevojë që të shkojnë në zyrë të Komunës dhe të aplikojnë, por e gjithë puna kryhet nga vetëpunëtorët e QPS-së dhe kjo ka ndikuar jashtëzakonisht shumë te përfituesit e SAS-it;
- ✓ **Kutitë e ankesave të qytetarëve hapen çdo muaj** – Kutitë e ankesave nga viti 2010, nuk janë hap asnjëherë. Rregullorja për kutitë është aprovuar në Kuvend dhe kutitë për herë të parë janë hapur në muajin gusht të vitit 2014. Që nga atëherë janë hapur dhe do të hapen çdo muaj;
- ✓ **Aplikim online për subvencione** - Platforma është në fazën e testimit dhe do të jetë gati në janar të vitit 2016. Ky sistem do të lehtësojë dhe t'i bëjë më efikase procedurat e aplikimit;
- ✓ **Është bërë instalimi i pajisjes për votim digjital në Kuvend** – Me këtë kemi eliminuar votimin me dorë, duke përmirësuar tutje vendimarrjen në Kuvendin komunal;
- ✓ **Janë instaluar sensorët për matjen e ndotjes së ajrit në gjashtë pika kyçe të qytetit.** Përveç parametrave aktual, do të pasqyrohet edhe norma e ndotjes së lejuar sipas rregulloreve të BE-së, në

mënyrë që parametrat të krahasohen; Parametrat që maten janë: Dioksid Sulfuri (SO₂), Hidrogjen Sulfid (H₂S), Dyoksid i Azotit (NO₂), Ozoni (O₃), Grimcat PM₁₀ edhe PM₂₅, Monoksidi i Karbonit (CO), Amoniak (NH₃), Radioaktiviteti, Decibel Metër - Matës i zhurmë dhe temperatura. Sensorët janë vendosur në lagjet: "Bregu i Diellit" në rrugën "Enver Maloku"; në lagjen "Dodona", rruga "Afrim Loxha"; në lagjen "Dardania", rruga "Ilaz Kodra"; në lagjen "Ulpiana", rruga "Mujë Krasniqi"; në "Qendër" në sheshin "Zahir Pajaziti"; në lagjen "Kodra e Trimave", rruga "Vëllezërit Fazliu"; Të gjitha rezultatet për secilën pikë, mund të lexohen në uebfaqe të Komunës së Prishtinës

- ✓ **Platforma digjitale 'OPEN DATA'** – përmes kësaj platforme bëhet pasqyrimi i të gjitha informacioneve të mbledhura nga drejtoritë komunale, me qëllim që këto shënime të përdoren më tutje në funksion të transparencës së plotë në Komunë, si dhe në funksion të zhvillimit lokal. Në këtë platformë janë të përfshira gjithsej 17 kategori, duke përfshirë edhe punën e kryetarit të Komunës të Prishtinës.
- ✓ **PRISHTINA IME - Platforma digjitale për participim publik** - Kjo platformë është pilot-projekt, i cili është krijuar me ndihmën e OSBE-së dhe iu ofron qytetarëve qasje 'online' dhe mundësi për propozimet e projekteve për lagjet e tyre, si dhe votimin për realizimin e projekteve të propozuara në lagje. Kjo e rrit transparencën dhe e obligon Komunën që të merret me kërkesat konkrete të qytetarëve dhe të planifikojë buxhetin komunal.
- ✓ **E-Inspekcioni – lajmëro parregullsitë në çdo moment dhe në çdo vend** - Aplikacion digjital për telefoni mobile, i cili do të mundësojë që qytetarët të paraqesin parregullsitë që vërejnë, duke i fotografuar dhe dërguar ato në adresën e duhur, që është Drejtoria e Inspekcionit dhe pastaj informata përcillet në drejtoritë tjera përkatëse.



- ✓ **Digjitalizimi i procesit të punës në Drejtorinë e Inspekcioni** - Për të shtuar efikasitetin e punës, për shkak të shpejtësisë së veprimit që kërkohet në terren, dhe për shkak të shpejtësisë së identifikimit, procedimit të rasteve dhe marrjes së vendimeve, kemi digjitalizuar procesin e punës në Drejtorinë e Inspekcioni. Përmes procesit të digjitalizuar bëhet regjistrimi i lajmërimeve, identifikimi i rasteve, procedimi i rasteve sipas rrjedhës, si dhe mbyllja e rastit apo dërgimi në një instancë tjetër. I gjithë procesi regjistrohet dhe arkivohet.
- ✓ **Qasja në dokumente zyrtare** - Digjitalizimi i qasjes në dokumentet zyrtare mundëson që kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, të parashtrihen në mënyrë digjitale. Procesi është plotësisht i automatizuar dhe pas përgatitjes së dokumenteve të kërkuara, Komuna përmes e-mailit, e informon qytetarin për të tërhequr dokumentin e kërkuar.
- ✓ **E-Fatura** - Tatimpaguesit, përmes shërbimit elektronik për tatimin në pronë "E-Fatura", mund të marrin e faturën, të përcjellin gjendjen, si dhe të bëjnë pagesën e tatimit në pronë në pikën më të afërt, në Postë apo në Bankë. Përmes përdorimit të këtij shërbimi elektronik, tatimpaguesit kursejnë kohën dhe koston dhe po ashtu, mundë ta përcjellin gjendjen në çdo kohë.
- ✓ **Evidentimi digjital i hapësirave publike të dhëna në shfrytëzim** - Duke shfrytëzuar 'Google Maps', qytetarët shumë shpejt do të mund të shikojnë, në çdo moment, statusin e të gjitha pronave publike:
 - a janë të lira,
 - kush është qiramarrësi,
 - për sa vjet është dhënë prona,
 - çmimi i pronës,
 - kur skadon kontrata etj.







Barazi në Prishtinë

- ✓ **Programi për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe çerdhe** – Ekipi profesional për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ka operuar sipas planifikimeve dhe dinamikës së paraparë për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjatë vitit 2016, nga ekipi vlerësues, janë vlerësuar njëzet e katër (24) nxënës, të cilët kryesisht vuajnë nga dëmtimet intelektuale dhe fizike, ku komisioni ka rekomanduar tetë **(8)** nga nxënësit të vijnë në mësimin në Qendrën Burimore "Përparimi" dhe të tjerët në shkollat e rregullta; Numri i fëmijëve të integruar është **441 fëmijë** (39 fëmijë të integruar në çerdhe, ndërsa **402** në shkolla fillore dhe të mesme).
- ✓ Në vitin 2014, Komuna ka ndarë **50 mijë euro** të kursyera gjatë vitit me subvencione, për rastet më të rënda sociale.
- ✓ Pas përfundimit të ndërtimit dhe sanimit të shumë problemeve teknike në 50 banesat e dedikuara për dhënie në shfrytëzim familjeve në nevojë, dhe përgatitjes disamujore për mbarëvajtje të procesit, pas formimit të Komisionit për ndarjen e këtyre banesave, ka filluar procesi i ndarjes së tyre. Kanë aplikuar mbi **300 familje** dhe i gjithë procesi po zhvillohet në prani të vëzhguesve të shumtë nga shoqëria civile, mediat dhe Institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Konform afateve kohore do të shpallen rezultatet, përmes sistemit të pikëzimit, i cili do të jetë komplet transparent dhe i qasshëm për publikun dhe të interesuarit në mënyrë të vazhdueshme.
- ✓ Në fund të vitit 2014, **11 familje u larguan nga kontejnerët**, ku kishin banuar me vite të tëra pa kushte elementare për jetë. Të gjitha këto familje tani jetojnë në shtëpi/banesa qiranë e të cilave e paguan Komuna e Prishtinës.
- ✓ **10 familje të tjera**, të cilat kishin mbetur pa kulm mbi kokë për arsye të ndryshme janë ndihmuar nga Komuna e Prishtinës. Edhe këto familje janë vendosur në shtëpi/banesa,

qiranë e të cilave e paguan Komuna.

- ✓ Për tre vjet radhazi, Komuna e Prishtinës ka bërë shpërndarjen e më shumë se 200 metra kub dru nga 2 metra kub për 100 familje.
- ✓ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale çdo vit ka ndarë subvencione, ndihmë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Duke parë nevojën e madhe për ndihmë sociale, në vitin **2014** kemi ndarë **100,000.00 euro** ndërsa në vitin **2015** e kemi dyfishuar shumën në **250,000.00 euro**. Gjatë vitit 2015, ka pasur rreth 2500 aplikime për subvencione të kategorive sociale dhe trajtimeve mjekësore. Janë ndarë subvencione për rreth 1500 familje nga kategoritë sociale dhe rreth 650 për trajtime mjekësore. Janë ndarë subvencione edhe për 15 familje pas fatkeqësive natyrore. Shuma totale e shpërndarë në këto raste është rreth 250.000 euro. Në vitin 2016, kanë aplikuar mbi **2300 qytetarë** dhe familje të ndryshme për nevoja të ndryshme, , qoftë sociale apo shëndetësore. Janë përkrahur **1910 familje**, individë dhe OJQ që përfaqësojnë kategori të ndryshme me nevoja specifike. Shuma e subvencioneve për vitin 2016 ka qenë **290,000.00 euro**.

Për tri vjet kemi ndarë 640,000.00 euro subvencione për familje me gjendje të rëndë ekonomike.

- ✓ **Programi për qasje në institucionet publike për personat me aftësi të kufizuara** – Gjatë këtyre tri viteve është bërë përmirësimi i infrastrukturës për lëvizje të pakufizuar dhe qasje më të lehtë në të gjitha institucionet publike komunale. Të gjitha projektet që kanë filluar dhe përfunduar gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, janë punuar me standardet e kërkuara për bërjen e Prishtinës qytet të qasshëm për të gjithë qytetarët.

Në fillim të vitit 2015, në zonën "Qendër" nga ekipi profesional për evidentimin e të gjitha barrierave arkitektonike në qytet, është bërë identifikimi i pengesave në lëvizjen e lirë të personave me nevoja të veçanta në trotuare, vendkalimeve për këmbësorë, sheshe, hapësira publike dhe parkingje. Po ashtu, janë bërë vizita nëpër banesat kolektive, ku banojnë personat me nevoja të veçanta, në institucionet shtetërore, lokale, spitale e qendra të Mjekësisë Familjare dhe shkollave. Pas kësaj janë bërë projektet për intervenime në tri lagje të Prishtinës, në lagjet "Dardania", "Kodra e Diellit" dhe "Ulpiana". Janë identifikuar institucionet shtetërore, lokale, spitale e qendra të Mjekësisë Familjare dhe shkolla ku, nevojat për intervenim janë



Lirimi nga pagesa për shërbime komunale për rastet sociale dhe grupet e rrezikuara

immediate për instalimin e ashensorëve.

Është bërë **instalimi i dy ashensorëve në QKMF dhe QMF - VI** për qëllim të lehtësimit të marrjes së shërbimeve shëndetësore nga individët me aftësi të kufizuara.

Është **instaluar ashensori i jashtëm panoramik në objektin e vjetër të Komunës**. Ky ashensor do të mundësojë qasje të lehtë në të gjitha katet e ndërtesës të gjithë personave e posaçërisht personave me nevoja të veçanta, nënave me karroca dhe personave të moshuar.

Është **Instaluar lift-platforma** – Ky lift-platformë do të mundësojë qasje të lehtë të gjithë personave me nevoja të veçanta, nënave me karroca dhe personave të moshuar në ofiqari dhe sportele të tjera që gjenden në katin e parë.

Është bërë **instalimi i dy lifteve në QKMF dhe QMF -VI** për qëllim të lehtësimit të marrjes së shërbimeve shëndetësore nga individët me aftësi të kufizuara.

- ✓ Është bërë lirim i trotuareve në shumë rrugë të qytetit, adaptimi i trotuareve dhe nivelimi i vendkalimeve, për të krijuar qasje të lehtë personave me

nevoja të veçanta;

- ✓ **Lirimi nga pagesa për shërbime komunale për rastet sociale dhe grupet e rrezikuara** - Në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS), rastet sociale janë liruar nga pagesa e taksës prej tre (3) eurove nga Drejtoria e Kadastrit. Në bashkëpunim me QPS-në, palët tani aplikojnë drejtëpërdrejtë në QPS ndërsa ne si drejtori në baza javore dërgojmë raport në lidhje me posedimin / mos posedimin e pronave të paluajtshme të aplikuesve për asistencë sociale drejtëpërdrejtë në QPS;
- ✓ **Programi i integritetit të personave me aftësi të kufizuara në vendet e punës** – Në muajin nëntor 2015, në pozitën e telefonistit është punësuar një person me aftësi të kufizuar (i verbër). Po ashtu, në kuadër të programit organizohet çdo vit "Muaji i mundësive të barabarta profesionale për persona me aftësi të kufizuara", ku u mundësohet 10 personave me aftësi të kufizuar, të jenë pjesë e stafit për dy ditë në drejtori të ndryshme të Komunës;
- ✓ **Krijimi i kushteve dhe mundësive për pjesëmarrje të të rinjve me nevoja të veçanta në aktivitetet kulturore dhe sportive**, të organizuara nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, siç ishte pjesëmarrja e Shoqatës së të Shurdhërve me aktivitetin "Prishtina me valle" në festivalin "Ylberi i Prishtinës";



Shëndeti në shërbim të zhvillimit

- ✓ **Vizita të rregullta sistematike mjekësore e stomatologjike në të gjitha shkollat për klasat 1 dhe 5**
- ✓ **Zonimi i qytetit:** secili banor e ka mjekun e vet.

Shpërndarja racionale e punëtorëve shëndetësorë në vendet ku ka më shumë nevojë;

Përcaktimi i nevojave për procesin e digjitalizimit dhe analiza e ndarjeve zonale;

Furnizimi me pajisje dhe lidhja me internet, i të gjitha institucioneve shëndetësore në komunën e Prishtinës, si domosdoshmëri për proces të digjitalizimit.

- ✓ **Instalimi i aparaturave për monitorimin e orarit të punës.**
- ✓ **Instalimi dhe funksionalizimi i sistemit digjital "PARATUS" në Qendrën e Mjekësisë Urgjente, që digjitalizon përmes tabletëve dhe hartave të parainstaluara, shërbimet urgjente në terren duke lidhur terrenin me Qendrën e Mjekësisë Urgjente dhe Qendrën Emergjente në QKUK, për të shkurtuar kohën e veprimit.**

✓ **Sistemi i informimit në shëndetësi, secili banor ka kartelën e vet digjitale.**

Hapja e faqes elektronike në QKMF, si hap i parë i informimit mbi shërbimet dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore <http://qkmf-pr.org/>.

Instalimi i sistemit të menaxhimit të radhës në njësitë laboratorike. Në këtë drejtim ka filluar edhe harmonizimi i aparaturave me këtë sistem, duke instaluar aparaturat digjitale që lidhen me sistemin e digjitalizimit, si: rëntgeni digjital, aparatet laboratorike, EKG-të e të tjera.

✓ **Shërbime të patronazhit, vizita për pacientët në nevojë nëpër shtëpitë e tyre**

Ngritja e kapaciteteve në resurse humane, ku janë pranuar punëtorë shëndetësorë shtesë për këtë shërbim;

Pajisja e gjithë punëtorëve në shërbim të patronazhit, me aparaturën dhe materialin e nevojshëm për shërbime cilësore shëndetësore;

Proces-blerja e 3 automjeteve për funksionalizimin e 3 ekipeve operuese të vazhdueshme për këtë shërbim.

✓ **Dezinsektimi** - Procesi i dezinfektimit, për herë të parë i realizuar në mbi 6,000 hektarë dhe në 5 faza, ku janë përfshirë edhe fshatrat e Prishtinës dhe rajone të rrezikuara nga insektet.





Prishtina e sigurt

**Zgjerimi, mirëmbajtja dhe modernizimi
i rrjetit të vjetërsuar të ndriçimit publik**

- ✓ Gjatë viteve **2014-2015**, kemi bërë ndriçimin e **94 km** rrugë në fshatra dhe qytete;
- ✓ Në vitin **2016** janë realizuar **18.1km** rrugë ndërsa janë në realizim **10** km rrugë;



- ✓ **Vendosja e matësve të shpejtësisë afër shkollave për të përmirësuar sigurinë** – Është bërë afër shkollave dhe në rrugët ku rrezikshmëria është cilësuar të jetë më e lartë: shkolla fillore *"Model"*, *"Ismail Qemali"*, *"Hoxhë Kadri Prishtina"*, rr. *"Enver Maloku"* afër shkollës fillore *"Ismail Qemali"*, Kodra e Diellit, rr. *"Tahir Zajmi"* Kalabri, Rruga e Zagrebit *"Tophane"*, rr. *"Nazim*

Gafurri" afër shkollës *"Gjergj Fishta"* Taukbahçe, rr. *"Dr.Shpëtim Robaj"*, afër shkollës *"Gjin Gazulli"* Sofali, rr. *"Isa Kastrati"*, afër shkollës *"Mitrush Kuteli"* Mati, rr. *"Isa Kastrati"*, afër shkollës *"Iliria"* Kodra e Diellit, rr. *"Lidhja e Prizrenit"*, afër shkollës *"Meto Bajraktari"* Tophane, dhe rr. *"Ilir Konushevci"*, afër shkollës *"Emin Duraku"*.

Ngritja e vendkalimeve është bërë në këto rrugë:

"George Bush", "Luan Haradinaj", "Fehmi Agani", "Enver Maloku", "Lidhja e Prizrenit" (afër shkollës "Meto Bajraktari"), "Lidhja e Prizrenit" (afër Shkollës së Gjelbër), afër shkollës "Eqrem Qabej", "Vëllezërit Fazliu" (afër shkollës "Asim Vokshi").

Vendosja e pengesave është bërë në këto rrugë:

"Hamdi Gashi" Velani, "Ahmet Krasniqi" Arbëria (3 pengesa), "Zagrebit" Arbëri (2 pengesa), "Carraleva" Bajram Bahtiri afër Medresesë, "Ardian Krasniqi" në Lagjen e Muhaxhirëve, "Vëllezërit Fazliu" Kodra e Trimave, "Hyzri Talla" Kodra e Trimave, "Mic Sokoli" Kodra e Trimave, "Haxhi Zeka", "Dr.Shpëtim Robaj" Sofali (2 pengesa), "Idriz Gjilani" Dardania (2 pengesa), "Imzot NikëPrela" Ulpianë (3 pengesa), "Isa Kastrati" Kodra e Diellit, "Isa Kastrati" lagjja Dodona, "Asllan Pirreva" Kodra e Trimave, "Rexhep Shema", "Rasim Kiçina", "Rilindja" Veternik, "Dëshmorët e Gollakut" Hajvali, "Dëshmorët e Marecit" Velani, "Gucia", "Malush Kosova" Lagjja e Spitalit, "Luan Haradinaj" Qendër, "Xhorxh Bush" Qendër, "Fehmi Agani" Qendër, "Vëllezërit Fazliu" Kodra e Trimave,



"Lidhja e Prizrenit" Tophane (3 pengesa), "Remzi Salihu" afër Medresesë, "Enver Maloku" Kodra e Diellit, "Gazmend Zajmi" Lagjja e Muhaxhirëve, "Gjergj Balsha" Arbëri, "Arkitek Karl Gega" Lagjja e Muhaxhirëve dhe "Nëntori" Dardani, rr. "Ismajl Domoshi" Taukbahçe afër shkollës "Gjergj Fishta", rr. "Mic Sokoli", afër shkollës "Zenel Hajdini", Kodra e Trimave, rr. "Bajram Bahtiri" afër shkollës "Nazim Gafurri" Gjinaj, rr. "Idriz Gjilani" afër shkollës "Xhemajl Mustafa" Dardani, rr. "Ilaz Kodra" afër shkollës "Dardania" Dardani, rr. "Zija Shemsiu" afër shkollës "Hasan Prishtina" Ulpianë, rr. "Ibrahim Lutfiu", lagjja "Velusha", rr. "1 Tetori" Velani, rr. "Bill Clinton" Lakërishtë, rr. "Xheladin Hana" dhe "Zenel Salihu".





Lirimi i trotuareve – deri më tani masat anti-parking janë vendosur në mbi 35 rrugë:

"Xhorxh Bush" (89 shtylla), "Qamil Hoxha" (142 shtylla), "Rexhep Luci" (346 shtylla), "Ilir Konusheci" (158 shtylla), "UÇK-së" (365 shtylla), "Luan Haradinaj" (140 shtylla), "Fehmi Agani" (231 shtylla), "Idriz Gjilani" (18 shtylla), "Bill Clinton" (125 shtylla), "Tirana" (251 shtylla), "Agim Ramadani" (119 shtylla), "Ardian Krasniqi" (103 shtylla), "Eqrem Çabej" (133 shtylla), "Fazli Grajqevci" (58 shtylla), "Fehmi Lladrovci" (58 shtylla), "Ibrahim Lutfiu" (43 shtylla), "Gorge Bush" (186 shtylla), "Qamil Hoxha" (315 shtylla), "Sylejman Vokshi" (24 shtylla), "Fehmi Agani" (287 shtylla), "Ilaz Kodra" (858 shtylla), "Perandori Justinian" (248 shtylla), "Dëshmorët e Kombit" (186 shtylla), "Fehmi Lladrovci" (105 shtylla), "Dr. Shpëtim Robaj" (51 shtylla), "Ruga B" (28 shtylla), "Muahrrem Fejza" (18 shtylla), "Armend Daci" (89 shtylla), rruga te Stacioni i Autobusëve (15 shtylla) dhe rruga te rrethi i ri (25 shtylla) - rrugë që lidhin rrugët "Magjistrale M2", Mitrovicë, Ferizaj, dhe Shkup, "28 Nëntori" (48 shtylla), pllatoja Kurriz (31 shtylla), "Enver Maloku" (12 shtylla), rruga "Fatmire Sokoli" Kalabri (16 shtylla) "Arkitek K.Gega" (30 shtylla). rr. "Dëshmorët e

Kombit" (498 shtylla), rr. "Eqrem Çabej" (65 shtylla), rr. "Ilir Konusheci" (178 shtylla), rr. "Hyzri Talla" (566 shtylla), rr. "Tirana" (213 shtylla), rr. "Ibrahim Lutfiu" (264 shtylla), rr. "Bajram Bahtiri" (105 shtylla).



Vendosja e panelave ndriçuese për ngritjen e sigurisë në komunikacion:

Rr. "1 Tetori", rr. "Agim Ramadani", rr. "Bill Clinton", rr. "Dëshmorët e Kombit", rr. "Fehmi Lladrovci", rr. "Eqrem Çabej", rr. "Xheladin Rekalii", rr. "Enver Maloku", rr. "Muharrem Fejza", rr. "Vëllezërit Fazliu", rr. "Bajram Bahtiri", rr. "Mon Balaj".

Furnizim i pandërprerë me ujë për 24 muaj

Me punën e bërë nga viti 2014 deri më tani, kemi arritur që në **8 lagje të mëdha të qytetit të ketë furnizim të pandërprerë me ujë - 24 orë në ditë**. Deri në fund të këtij mandati, planifikojmë që i gjithë qyteti të ketë furnizim të pandërprerë.

Rregullimi i trafikut në Prishtinë

Reformimi i transportit publik – Tashmë ka filluar reforma, në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Zhvillim, në një program mbi 10 milionë euro ku është përfunduar:

- Vlerësimi teknik dhe ambiental dhe në bazë të të cilit raport është bërë përzgjedhja e llojit të autobusëve që përshtaten me kushtet infrastrukturore dhe ambientale të Prishtinës;
- Gjatë vitit është hapur tenderi ndërkombëtar, është bërë hapja e ofertave, ku 4 kompani ndërkombëtare kanë aplikuar për furnizimin e Prishtinës me 51 autobusë, dhe është përzgjedh kompania. 15 autobusët e parë kanë arritur në Prishtinë, 15 autobusë të tjerë do të arrijnë në javën e tretë të muajit janar, ndërsa pjesa e mbetur 21 autobusë do të arrijnë në muajin mars;
- Në pjesën e parë të 2016, do të vazhdohet me planin e mobilitetit, që do t'i caktojë linjat e reja dhe do të finalizohet projekti për sistemin e integruar të biletave.

Themelimi i kompanisë publike “Parking Prishtina” – Është themeluar ndërmarrja e kompanisë publike “Parking Prishtina” dhe të gjitha përgatitjet teknike dhe operative janë bërë për nisjen e ndërmarrjes për rregullimin e parkingut në zona publike në Prishtinë. Zonimi për parking – zona I ka përfunduar, si dhe zona III, ndërsa është duke u bërë zonimi i lagjeve.

Transport falas për pensionistët -

Tashmë dy vjet Komuna ka siguruar transportin falas për pensionistë, për linjat 3 dhe 4. Me ardhjen e autobusëve të rinj dhe krijimin e linjave të tjera, pensionistët do të kenë mundësi të udhëtojnë edhe në linja tjera.





Vendimmarrja në lagje

Funksionalizimi i bashkësive lokale –

Në bashkëpunim me Demos, kemi filluar procesin e funksionalizimit të bashkësive lokale. Propozimvendimi për Rregulloren e re për bashkësi lokale është lënë në diskutim publik. Fillimisht me kryetarët e bashkësive lokale është diskutuar ndryshimi dhe plotësimi i rregullores së vjetër. Janë miratuar të gjitha ndryshimet e paraqitura nga kryetarët e bashkësive lokale, pas konsultave të tyre me këshillat e lagjeve dhe të fshatrave. Pastaj kjo rregullore i është prezentuar edhe grupit punues, të formuar nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike pjesëmarrëse në Kuvendin komunal.

Kjo metodologji e përgatitjes së një Rregulloreje në Komunën e Prishtinës, me konsultatë të të gjithë faktorëve relevantë që do ta implementojnë këtë Rregullore (përfaqësuesit e bashkësive lokale), për herë të parë aplikohet në ndonjë nga komunat e Kosovës. Ende në komuna aplikohet metodologjia e miratimit të rregulloreve në kuvende komunale pa asnjë konsultë

paraprake me ata që duhet të zbatojnë atë rregullore – thjesht, u prezantohet si rregullore e përfunduar dhe e miratuar.

Pas vërejtjeve eventuale që mund të vijnë gjatë dëgjimeve publike, Rregullorja do të dorëzohet për miratim në Kuvendin e Komunës dhe pas miratimit, do të organizohen zgjedhjet e reja për këshillat e bashkësive lokale.

Këshillat e lagjeve –

Në rregulloren për funksionimin e bashkësive lokale, është paraparë edhe përzgjedhja dhe formimi i këshillave në lagje, por i tërë procesi ka ngecur për shkak të bllokadës në Kuvend.

Tubimet në lagje –

Proces i vazhdueshëm – gjatë këtyre tri viteve, Komuna e Prishtinës ka mbajtur 120 diskutime publike për çështje të ndryshme me banorë të lagjeve dhe fshatrave të komunës së Prishtinës.

Banim i përballueshëm

Banimi i përballueshëm do të zhvillohet si program në vitin 2017. Në tetor të këtij viti, në Konferencën për Investitorë, u prezantua projekti për ndërtimin e kompleksit banesor në lagjen “Bregu i Diellit”, ku u ftuan investitorët të investojnë në realizimin e këtij projekti. Me realizimin e këtij projekti, Komuna e Prishtinës përfiton një fond banesor, të cilin do ta përdor për realizimin e projektit për sigurimin e banimit të përballueshëm për punëtorët e sektorit publik.

Reformimi i tatimit në pronë

Me rregulloren e re të tatimit në pronë është bërë reformimi i tatimit në pronë, me ç’rast baza tatimore është ndryshuar, duke u përafëruar me vlerat e tregut. Tanimë lagjet ku pronat janë më të shtrenjta, vlera e tatimit në pronë është më e lartë. Ndërsa në lagjet periferike ku vlera e pronës është më e ulët dhe ku banorët janë në gjendje më të rëndë socio-ekonomike, paguajnë më pak. Tatimi në pronë është bërë më i drejtë. Pra, lagjet me standard më të lartë të mirëqenies, bartin barrën më të madhe nga shuma e përgjithshme e arkëtimit të tatimit në pronë. E gjitha e harmonizuar me dokumentin e reformimit-analizës së tatimit në pronë.

